



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
**ZYRA E AUDITORIT TË PËRGJITHSHËM**

**Nr. i Dokumentit: 24.1.1--2015-08**

**RAPORTI I AUDITIMIT**  
**PËR PASQYRAT FINANCIARE TË DOGANËS SË KOSOVËS**  
**PËR VITIN E PËRFUNDUAR MË 31 DHJETOR 2014**

**Prishtinë, Qershor 2015**

Zyra e Auditorit të Përgjithshëm kryen auditime të rregullsisë dhe të performancës. Auditori i Përgjithshëm në Detyrë është kreu i Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm, i cili ka rreth 145 të punësuar. Auditori i Përgjithshëm dhe Zyra e Auditorit të Përgjithshëm janë të pavarur dhe çertifikon rreth 90 Pasqyra Vjetore Financiare çdo vit, derisa ndërmarrin edhe forma të tjera të auditimit.

Misioni ynë është që të kontribuojmë në menaxhim të shëndoshë financiar në administratë publike. Ne do të kryejmë auditime cilësore në përputhje me standardet e njohura ndërkombëtare të auditimit të sektorit publik dhe praktikat e mira evropiane. Ne do të ndërtojmë besim në shpenzimin e fondeve publike. Ne do të luajmë një rol aktiv në sigurimin e interesit të taksapaguesve dhe palëve tjera të interesit në rritjen e llogaridhënies publike.

Raportet e nxjerra nga Zyra e Auditorit të Përgjithshëm promovojnë drejtpërsëdrejti llogaridhënien pasi që ato ofrojnë bazë për ti kërkuar llogari menaxherëve të çdo organizate buxhetore.

Auditori i Përgjithshëm në Detyrë ka vendosur në lidhje me opinionin e auditimit dhe raportin mbi Pasqyrat Vjetore Financiare të Doganës së Kosovës në konsultim me Asistent Auditorin e Përgjithshëm, Ibrahim Gjylderen, i cili e ka mbikëqyrur auditimin.

Raporti dhe opinionin i lëshuar janë rezultat i auditimit të kryer nën menaxhimin e Drejtorit të Auditimit, Vlora Mehmeti, i mbështetur nga, Jusuf Kryeziu (Udhëheqës Ekipi), Besa Morina dhe Saranda Husaj.

## TABELA E PËRMBAJTJES

Përmbledhje e përgjithshme.....	4
1 Fushëveprimi i auditimit dhe metodologjia .....	6
2 Pasqyrat vjetore financiare dhe obligimet e tjera për raportimin e jashtëm .....	8
3 Rekomandimet e vitit paraprak.....	11
4 Qeverisja.....	12
Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZAP.....	24
Shtojca II: Rekomandimet e vitit paraprak .....	27

## Përmbledhje e përgjithshme


### Hyrje

Ky raport përmbledh çështjet kryesore që dalin nga auditimi ynë i Pasqyrave Vjetore Financiare të Doganës së Kosovës për vitin 2014 – i cili e përcakton Opinionin e dhënë nga Auditori i Përgjithshëm. Unë do të doja të falënderoja Drejtorin e Përgjithshëm dhe stafin e tij për ndihmën e tyre gjatë procesit të auditimit.

Ekzaminimi i pasqyrave financiare për vitin 2014 u ndërmor në përputhje me standardet e njohura ndërkombëtarisht të auditimit në Sektorit Publik (SNISA) të nxjerra nga INTOSAI. Qasja jonë ka përfshirë testet dhe procedurat, të cilat ne menduam se ishin të nevojshme për të arritur në një opinion lidhur me pasqyrat financiare. Qasja e ndërmarrë është paraqitur në Memon e Planifikimit të Auditimit, e datës 26 Shtator2014.

Dogana është agjenci ekzekutive e Ministrisë për Financa. Pasqyrat Vjetore Financiare të saj inkorporohen në kuadër të Pasqyrave Vjetore Financiare të Ministrisë për Financa. ZAP nuk është e obliguar që ta kryej një auditim të veçantë të PVF të doganës. Mirëpo, për shkak të natyrës dhe veprimtarisë që kryen DK si dhe si një shërbim ndaj nevojës së Komisionit për Mbikëqyrje të Financave Publike, ne kemi audituar PVF të Doganës ndarazi nga auditimi i PVF të MF-së.

Auditimi ynë është fokusuar në:



Niveli i punës së kryer nga Zyra e Auditorit të Përgjithshëm për të përfunduar auditimin për vitin 2014 pasqyron drejtpërsëdrejti cilësinë e kontrollit të brendshëm të zbatuar nga menaxhmenti.

### Opinion

Shtojca I shpjegon llojet e ndryshme të opinionëve të aplikuar nga ana e Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm.

Opinionit i Auditorit të Përgjithshëm është:


Sipas opinionit tonë pasqyrat financiare prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale.

Si Theksim i çështjes - Dëshirojm të theksojm faktin që evidencat e mbajtura dhe informatat e prezantuara tek shpalosjet e llogarive të arkëtueshme në PVF nuk ishin të plota. Kjo nuk ka ndikim në ndonjërin prej dy Pasqyrave Vjetore Financiare (Pranimet dhe Pagesat në Para të Gatshme dhe Krahasimi i Buxhetit me Shumat Aktuale), në pajtim me IPSAS në bazë të kontabilitetit të parasë së gatshme.

**(SNISA 200/1706 Opinion i Pamodifikuar me Theksim të Çështjes)**

### Konkluzioni i përgjithshëm

Konkluzionet dhe rekomandimet tona kryesore janë:



### Përgjigje nga Menaxhmenti - auditimi i vitit 2014

Menaxhmenti është pajtuar me të gjeturat tona të auditimit dhe është zotuar se do të adresoj rekomandimet tona.

# 1 Fushëveprimi i auditimit dhe metodologjia

Është përgjegjësi e Doganës së Kosovës (DK) të përgatisë Pasqyrat Vjetore Financiare (PVF) sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik (SNKSP) për “Raportimin Financiar në bazë të Kontabilitetit të Parasë së Gatshme” dhe kërkesave të tjera specifike. Zyra e Auditorit të Përgjithshëm (ZAP) është përgjegjëse për kryerjen e auditimit të rregullsisë që përfshin ekzaminimin dhe vlerësimin e pasqyrave financiare dhe të dhënave tjera financiare si dhe të shprehemi:

- Nëse PVF japin një pamje të drejtë dhe të vërtetë të llogarive dhe çështjeve financiare për periudhën e auditimit;
- Nëse të dhënat financiare, sistemet dhe transaksionet janë në pajtim me ligjet dhe rregulloret në fuqi;
- Për përshtatshmërinë e funksioneve të kontrollit të brendshëm dhe të auditimit të brendshëm; dhe
- Për të gjitha çështjet të cilat dalin apo kanë të bëjnë me auditimin.

Ne kemi shqyrtuar kontrollet menaxheriale, për të përcaktuar shkallën deri ku mund të mbështetemi në to, për përcaktimin e testimit të hollësishëm, i cili është i nevojshëm për të siguruar nivelin e nevojshëm të dëshmive, për të mbështetur opinionin e Auditorit të Përgjithshëm (AP). Aktivitetet e menaxhmentit përcaktojnë edhe fokusin e auditimit tonë të pajtueshmërisë dhe auditimit të qeverisjes së mirë të cilat nuk kanë ndikim të drejtpërdrejtë në opinion.

Qasja jonë audituese ndaj qeverisjes fokusohet në vlerësimin e veprimeve të ndërmarra nga menaxhmenti me qëllimin për të siguruar menaxhim efektiv financiar dhe kontroll, si dhe në vlerësimin e rezultateve të këtyre veprimeve në dhënien efikase të outputeve cilësore operationale. Kjo, për shembull, mund të jetë një aktivitet monitorimi i ndërmarrë nga menaxhmenti ose nga nivele më të ulëta të kontrolleve operationale. Ne konsiderojmë nëse kontrollet janë të dizajnuara mirë, nëse janë implementuar sipas planit dhe nëse operojnë në mënyrë efektive. Kjo kërkon një vlerësim të strukturave, proceseve dhe linjave të llogaridhënies të prezantuara nga menaxhmenti, përfshirë këtu edhe rolin e Auditimit të Brendshëm dhe të Komitetit të Auditimit si dhe kontrollet e brendshme të sistemit.

Pjesët e mëposhtme ofrojnë një përmbledhje më të detajuar të të gjeturave tona të auditimit me theks të veçantë në vëzhgimet dhe rekomandimet në çdo fushë të rishikimit. Një vlerësim i mënyrës se si Menaxhmenti i ka adresuar rekomandimet e bëra në vitin 2013 mund të gjendet në Shtojcën II.

Për të qenë më i plotë, ne kemi përfshirë çështjet e identifikuar gjatë auditimit të ndërmjetëm aty ku ato kanë mbetur relevante. Në fazën e auditimit të ndërmjetme ne ofrojmë këshilla me qëllim që të mundësojmë ndërmarrjen e veprimeve përkatëse para prodhimit të PVF-ve dhe para auditimit final.

Të gjeturat tona janë definuar si:

Të prioritetit të lartë - Çështje të cilat mund të rezultojnë në dobësi materiale në kontrollin e brendshëm dhe ku veprimi i marrë do të ofrojë mundësinë për përmirësimin e efikasitetit dhe efektivitetit të kontrolleve të brendshme; dhe

Të prioritetit të mesëm - Çështje të cilat mund të mos rezultojnë në dobësi materiale, por ku veprimi i marrë do të ofrojë mundësinë për përmirësimin e efikasitetit dhe efektivitetit të kontrolleve të brendshme.

Të gjeturat që konsiderohen si me prioritet të ulët do të raportohen veçmas stafit të financave.

Procedurat tona kanë përfshirë një rishikim të kontrolleve të brendshme dhe sistemeve të kontabilitetit dhe teste substanciale të shoqëruara me to vetëm deri në atë masë që konsiderohet e nevojshme për kryerjen efektive të auditimit. Të gjeturat e auditimit nuk duhet të konsiderohen sikur përfaqësojnë një pasqyrë gjithëpërfshirëse të gjitha dobësive të cilat ekzistojnë, apo edhe të gjitha përmirësimeve që mund të bëhen në sistemet dhe procedurat që kanë funksionuar.

## 2 Pasqyrat vjetore financiare dhe obligimet e tjera për raportimin e jashtëm

### Përshkrimi

Rishikimi ynë i PVF merr parasysh pajtueshmërinë me kornizën raportuese si dhe cilësinë dhe saktësinë e informacionit të regjistruar në pasqyrat financiare. Ne gjithashtu e marrim parasysh deklaratën e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ (ZKA) dhe Zyrtari Kryesor Financiar (ZKF), kur draft PVF-të të dorëzohen në Qeveri.

Deklarata në lidhje me prezantimin e PVF përfshin një numër të pohimeve për sa i përket pajtueshmërisë me kornizën raportuese dhe cilësinë e informacionit në kuadër të pasqyrave financiare. Disa deklaratë kanë për qëllim t'i ofrojnë Qeverisë sigurinë se të gjitha informatat relevante janë ofruar për të siguruar se mund të ndërmerret një auditim gjithëpërfshirës.

### Konkluzioni i përgjithshëm

DK ka arritur të dorëzoj me kohë të gjitha raportet të cilat kërkohen me kornizën e aplikueshme ligjore. PVF-të kanë përmbushur të gjitha kërkesat e SNKSP "Raportimi Financiar sipas Kontabilitetit të Parasë së Gatshme" dhe Rregullës Financiare nr. 03/2013. Dogana nuk i ka adresuar gabimet lidhur me llogarit e arkëtueshme në PVF. Pavarësisht kësaj, cilësia e PVF-ve në përgjithësi ishte e mirë.. Të gjitha obligimet e tjera të raportimit të jashtëm që nuk kanë lidhje me PVF ishin përmbushur plotësisht.

### 2.1 Opinioni i Auditimit

Sipas opinionit tonë pasqyrat financiare prezantojnë *një pamje të drejtë dhe të vërtetë* në të gjitha aspektet materiale.

Si Theksim i çështjes - Dëshirojm të theksojm faktin që evidencat e mbajtura dhe informatat e prezantuara tek shpalosjet e llogarive të arkëtueshme në PVF nuk ishin të plota. Kjo nuk ka ndikim në ndonjërin prej dy Pasqyrave Vjetore Financiare (Pranimet dhe Pagesat në Para të Gatshme dhe Krahasimi i Buxhetit me Shumat Aktuale), në pajtim me IPSAS në bazë të kontabilitetit të parasë së gatshme.

**(SNISA 200/1706 Opinion i Pamodifikuar me Theksim të Çështjes)**



## 2.2 Rreziqet domethënëse në Pasqyrat Vjetore Financiare

### Përshkrimi

Në Memon tonë të planifikimit të auditimit, e datës 26/09/2014, nuk janë identifikuar rreziqe domethënëse, mirëpo gjatë kryerjes së auditimit kemi identifikuar një rrezik të tillë në PVF lidhur me plotësinë e llogarive të arketueshme.

Rreziku që ne kemi identifikuar në lidhje me plotësinë dhe saktësinë e llogarive të arketueshme ka ndodhur për shkak se menaxhmenti nuk kishte ndërmarrë veprime për sigurimin e shënimeve të plota të llogarive të arketueshme.

### Rreziku i identifikuar

**Çështja 1 - Shënime (regjistër) të pa qarta dhe jo të plota të llogarive të arketueshme - Prioritet i lartë**

### Përgjigja dhe të gjeturat e auditimit

Në PVF-të 2014, Dogana ka prezantuar llogari të arketueshme në vlerë prej 34,617,788€. Dogana nuk ka mundur të ofroj një bazë të plotë të llogarive të arketueshme, në mënyrë që të konfirmoj vlerën e të arketueshmeve të shpalosura në PVF 2014.

Informatat (baza e të dhënave) e ofruara nga dogana për llogarit e arketueshme gjatë auditimit nuk ishin të qarta. Në ato të dhëna ishte e vështir të nxirren saktësishtë borxhlinjtë si dhe periudha se kur është krijuar obligimi. Si rezultat i kësaj, ne nuk kemi mundur që të fitojmë sigurin për saktësinë dhe plotësinë e llogarive të arketueshme të shpalosura në PVF 2014.

Pas përfundimit të auditimit (punës në teren) dogana e ka dërguar edhe një bazë të të dhënave për llogarit e arketueshme. Edhe në këto të dhëna, të cilat ishin të ndryshme nga të dhënat e prezantuara gjatë auditimit, dogana nuk ka mundur të mbështet shifrën e llogarive të arketueshme të prezantuara në PVF 2014.

**Rekomandimi 1 Prioritet i lartë.** Drejtori i Përgjithshëm duhet të ndërmerr veprime konkrete për të siguruar se regjistrat lidhur me llogarit e arketueshme janë të sakta dhe të plota.

## 2.3 Pajtueshmëria me PVF dhe kërkesat tjera për raportim

### Përshkrimi

DK duhet të jetë në përputhje me kornizën e caktuar raportuese dhe kërkesat tjera për raportim. Ne kemi marrë parasysh:

- Pajtueshmërinë me Rregullës Financiare nr. 03/2013;
- Kërkesat e LMFPP-së nr. 03/L-048;
- Kërkesat e buxhetit;
- Raportet tremujore, duke përfshirë pasqyrat financiare nëntë mujore;
- Planin e veprimit për adresimin e rekomandimeve të auditimit;
- Plani preliminar dhe final të prokurimit;
- Raportet për borxhet e papaguara; dhe
- Raportet e progresit për projektet kapitale me vlerë mbi 10,000€.

Në kontekst të PVF-ve dhe obligimeve tjera për raportim të jashtëm, ne nuk kemi asnjë çështje për të ngritur në lidhje me këto.

Marrë parasysh atë më lart - Deklarata e bërë nga ZKA dhe ZKF, me dorëzimin e draft PVF-ve në Qeveri, mund të konsiderohet e drejtë dhe e vërtetë në përjashtim të llogarive të arkëtueshme të prezantuara në PVF 2014.

### Rekomandimi

Ne nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

### 3 Rekomandimet e vitit paraprak

#### Konkluzioni i përgjithshëm

Që prej pranimit të rekomandimeve tona në korrik 2014 për vitin 2013, DK ka ndërmarrë masa adekuate për t'i adresuar shqetësimet e ngritura. Përkundër progresit edhe më tutje mbasin çështje për t'u adresuar.

#### Përshkrimi

Raporti jonë i auditimit për PVF-të e vitit 2013 ka rezultuar me shtatë (7) rekomandime. DK ka përgatitur një Plan Veprimi për të siguruar se të gjitha rekomandimet adresohen brenda periudhës së specifikuar. Progres vërehet pothuaj në të gjitha komponentët, megjithatë mangësi vërehen në llogaritë e arketueshme dhe depot doganore.

Deri në fund të auditimit tonë për vitin 2014, pesë rekomandime janë adresuar plotësisht, një pjesërisht dhe një nuk janë adresuar fare. Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrës se si janë adresuar ato, shihni Shtojcën II.

#### Rekomandimi

---

##### Çështja 2 - Adresimi i rekomandimeve nga viti paraprak – Prioritet i lartë

- |                      |  |
|----------------------|--|
| <b>E gjetura</b>     | Edhe pse një pjesë e madhe e rekomandimeve të vitit të kaluar janë zbatuar, për DK ende mbetet sfida adresimi i plotë i rekomandimeve të AP-së lidhur me depot doganore dhe llogarit e arkëtueshme.  |
| <b>Rreziku</b>       | Dobësitë e vazhdueshme të kontrolleve të menaxhmentit dhe kontrolleve tjera në sistemet kyçe, si depot doganore kanë rezultuar në mangësi të dukshme të kësaj fushe të cilat mund të ndikojnë në efikasitetin e organizatës në tërësi.   |
| <b>Rekomandimi 2</b> | Drejtori i Përgjithshëm duhet të sigurojë se masat e përcaktuara në planin e veprimit për depot doganore dhe llogarit e arkëtueshme të rishikohen dhe monitorohen në vazhdimësi për të siguruar që ato zbatohen plotësisht nga stafi llogaridhënës gjatë kryerjes së aktiviteteve të përditshme. |

## 4 Qeverisja

### Konkluzioni i përgjithshëm

Aspektet kyçe të kornizës së qeverisjes janë adresuar nga DK si në vazhdim:

- Vetëvlerësimi siç kërkohet me procedurat për menaxhimin financiar dhe kontrollin;
- Menaxhimi i rrezikut në përputhje me objektivat strategjike të DK-së i përshkruar në planin strategjik;
- Raportimi i brendshëm dhe kontrollet menaxheriale; dhe
- Sistemi i Auditimit të brendshëm.

Meqenëse, DK është organizata më e madhe në gjenerimin e të hyrave dhe njëkohësisht burimi kryesor i buxhetit të Kosovës; kontrollet mbi të hyrat në përgjithësi janë të forta dhe po zbatohen në mënyrë efektive, përveq disa mangësive të cilat duhet të përmirësohen. Përderisa, kontrollet mbi një sërë fushash të shpenzimeve kërkojnë përmirësim të mëtejshëm në mënyrë që të parandalojnë që DK të ketë humbje financiare, vlerë të dobët për paranë dhe menaxhim jo efektiv të parasë publike. Fushat kryesore ku nevojiten më shumë përmirësime janë Depot Doganore, menaxhimi i pasurisë, dhe menaxhimi i shpenzimeve.

### 4.1 Planifikimi dhe realizimi i Buxhetit

#### Përshkrimi

Ne i kemi shqyrtuar burimet e fondeve buxhetore për DK, shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike dhe të hyrat e inkasuara. Kjo është paraqitur në tabelat e mëposhtme:

**Tabela 1. Burimet e fondeve buxhetore – realizimi ndaj buxhetit (në €)**

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final <sup>1</sup>	2014 Realizimi	2013 Realizimi	2012 Realizimi
<b>Burimet e Fondeve:</b>	<b>9,781,070</b>	<b>9,888,901</b>	<b>9,075,456</b>	<b>8,144,009</b>	<b>8,130,889</b>
Granti i Qeverisë -Buxheti	9,781,070	9,888,901	9,075,456	8,144,009	8,130,889

Buxheti final është më i lartë se buxheti fillestar për 107,831€. Kjo rritje është zbatuar pas rishikimit buxhetor dhe në pajtim me vendimet e Qeverisë.

<sup>1</sup> Buxheti Final – buxheti i aprovuar nga Kuvendi që është e përshtatur vazhdimisht nga Ministria e Financave

Në vitin 2014, Dogana ka realizuar 92% të buxhet final ose 9,075,456€, një trend i njëjtë i realizimit krahasuar me vitin 2013.

**Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike- realizimi ndaj buxhetit (në €)**

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2014 Realizimi	2013 Realizimi	2012 Realizimi
<b>Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike:</b>	<b>9,781,570</b>	<b>9,888,900</b>	<b>9,075,456</b>	<b>8,144,000</b>	<b>8,130,889</b>
Pagat dhe Mëditjet	4,625,875	5,387,684	5,387,684	4,620,000	4,552,211
Mallrat dhe Shërbimet	3,784,682	3,216,980	2,587,523	3,027,000	2,552,898
Shërbimet komunale	228,000	193,375	146,441	155,000	136,282
Investimet Kapitale	1,143,013	1,090,861	953,808	342,000	889,498

Shpjegimet rreth ndryshimeve në kategoritë buxhetore janë në dhënë si në vijim:

Buxheti për Paga dhe Mëditje është rritur për 761,810€, kjo ka ndodhur si rezultat i vendimit të qeverisë për rritjen e pagave për 25%. Buxheti për këtë kategori për 2014 është shpenzuar 100%.

Buxheti final për Mallra dhe Shërbime në raport me buxhetin fillestar është zvogëluar për 567,702€. Buxheti final është realizuar për 80% e që mbetet në nivel jo të kënaqshëm. Trend i njëjtë i realizimit të kësaj kategorie ishte edhe vitin e kaluar.

Buxheti final për Shërbime komunale në raport me buxhetin fillestar është zvogëluar për 34,625€ si rezultat i vendimit të Qeverisë. Buxheti për këtë kategori është realizuar 75%.

Buxheti final për Investime kapitale në raport me buxhetin fillestar është zvogëluar për 52,152€. Buxheti për këtë kategori është realizuar 87%. Investimet Kapitale kryesisht janë realizuar në sektorin e teknologjisë informative.

**Tabela 3. Të hyrat e inkasuara për buxhetin e Kosovës - realizimi ndaj buxhetit (në €)**

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2014	2013	2012
Të hyrat	934,000,000	934,000,000	870,978,222	837,268,927	844,860,950
Kthimet	-	-	(2,407,787)	(3,189,265)	(2,073,633)
<b>Totali</b>	<b>934,000,000</b>	<b>934,000,000</b>	<b>868,570,435</b>	<b>834,049,662</b>	<b>842,787,317</b>

Të hyrat e planifikuara nga Dogana për vitin 2014 ishin 934,000,000€. Përderisa, realizimi i tyre ishte 868,570,435€, shprehur në përqindje kemi një realizim prej 93% të kuotës së planifikuar.

Dogana nuk e ka realizuar planin plotësisht. Nga trendi i të hyrave nëpër vite vërehet se Dogana ka një ngritje të të hyrave në raport me vitin paraprakë për 34,520,773€.

---

### Çështja 3 - Realizimi i buxhetit - Prioriteti i Lartë

- E gjetura** Edhe pse buxheti në total ishte realizuar në masën prej 92%, buxheti për mallra dhe shërbime dhe shërbime komunale edhe përkundër shkurtimeve buxhetore nuk është realizuar sipas planifikimit. Buxheti për mallra dhe shërbime ishte shpenzuar 74% ndërsa komunalet 75%. Buxheti për mallra dhe shërbime nuk ishte realizuar sipas planifikimit si pasojë e përsëritjes së aktiviteteve të prokurimit dhe reduktimi i shpenzimeve të qirasë si rezultat i zhvendosjes nga Veternik-u në ish objektin e FSK-së. Ndërsa buxheti fillestar për shërbime komunale për 2014 ishte i njëjtë me buxhetin për 2013, pavarësisht që nuk ishte realizuar në tërësi edhe në 2013.
- Rreziku** Planifikimi i buxhetit jo në përputhje me nevojat reale rezulton në mbajtje të buxhetit të paspenzuar pa nevojë i cili përndryshe do të mund të shfrytëzohej për fushat tjera prioritare të cilat kanë nevojë për më shumë fonde. Mungesa e një analize të bazuar në trendin historik të buxhetit për shërbime komunale ka pasur për pasoj mbajtjen e tepricave buxhetore.
- Rekomandimi 3** Drejtori i Përgjithshëm duhet të sigurojë se ka analizuar trendin historik të buxhetit për shërbime komunale dhe ka ndër marr masa për përmirësim. Po ashtu, për të rritur realizueshmërinë e buxhetit për mallra dhe shërbime ka analizuar mangësitë në procesin e prokurimit për evitimin e tyre në të ardhmen.

## 4.2 Të hyrat

### Përshkrimi

Të hyrat e gjeneruara nga Dogana në vitin 2014 ishin në total 868,570,435€. Në raport me vitin e kaluar, Dogana ka shënuar realizim më të lartë të të hyrave për 34,520,773€ apo 4%. Rritje më të madhe tregohet tek grumbullimi i akcizës në kufi, Dogana në import dhe Tatimi mbi vlerën e shtuar në kufi - dogana. Në vijim do ta paraqesim në mënyrë të detajuar të hyrat dhe kthimet për vitin 2014.

**Tabela. 4 të hyrat e detajuara sipas llojit dhe kthimet (Janar-Dhjetor/2014).**

Nr.	Përshkrimi	Vlera në Euro
1	Akciza e mbrendshme	(11,361,989)
2	Akciza në kufi	(304,075,245)
3	Banderollat	(477,598)
4	Dogana në import	(126,323,464)
5	Fast - dogana	(4,767)
6	Kontrolla e jashtme doganore	(1,231,752)
7	Kthimi I akcizës	123,922
8	Kthimi I taksave doganore	755,342
9	Kthimi I taksave tjera doganore	369,356
10	Kthimi I tatimit mbi vlerën e shtuar - dogana	1,159,167
11	Kundervajtje dhe denime doganore	(1,654,407)
12	Tatimet e taksave tjera nga dogana	(1,296,534)
13	Tatimi mbi vlerën e shtuar në kufi - dogana	(423,935,311)
14	Të hyrat nga shitja e mallrave	(617,155)
	<b>Totali i të hyrave për vitin 2014</b>	<b>(868,570,436)</b>

Ne kemi ekzaminuar 100 mostra (teste thelbësore), kryesisht në të hyrat nga: akciza në kufi, dogana nga importi dhe TVSh në kufi-dogana. Përveç kësaj kemi ekzaminuar depot doganore, kthimet e akcizave, taksave dhe TVSh-së, si dhe kemi aplikuar teste të pajtueshmerisë për disa mostra. Dogana e Kosovës në përgjithësi ka një sistem funksional në menaxhimin e të hyrave, përveç disa mangësive të cilat do ti prezantojmë si në vijim:

## Rekomandim

---

### Çështja 4 - Vlera e mallrave për qëllime doganore - Prioriteti i Lartë

**E gjetura** Në një rast kemi vërejtur që, importuesi i mallit ka prezantuar dokumentet e nevojshme për të dëshmuar blerjen e mallit, konkretisht faturën origjinale të lëshuar nga eksportuesi, e cila përfshin çmimin e mallit, njësin, sasin, peshën dhe përshkrimin e mallit. Megjithatë, dogana nuk i ka marr për bazë këto dëshmi gjatë procesit të përcaktimit të vlerës së mallit (importit), e cila ka anashkaluar nenin 33 të Kodit doganor për përcaktimin e vlerës në bazë të transaksionit, dhe ka aplikuar metodën e gjashtë (6), konkretisht nenin 35 të kodit doganor për përcaktimin e vlerës së mallit të importuar. Më tej, në dosjen e këtij importi nuk është dhënë ndonjë shpjegim (arsye) lidhur me kalimin nga metoda 1 në metodën 6 për vlerësimin doganor të mallrave të importuara.

**Rreziku** Kalimi nga një metodë në një tjetër pa pasur dëshmi të mjaftueshme përveç që është në kundërshtim me kodin doganor, ndikon në rritjen e rasteve të ankesave dhe njëkohësisht paraqet rrezik edhe për reputacionin e doganës e cila do të ndikoj në përgjithësi në performancën e organizatës.

**Rekomandimi 4** Drejtori i Përgjithshëm duhet të siguroj se ka shtuar nivelin e monitorimit në lidhje me vlerësimin e importeve doganore, si dhe të eliminoj dobësitë të cilat mund të paraqiten gjatë caktimit të vlerës doganore për mallrat e importuara.

### Çështja 5 - Mungojnë informata për gjendjen fillestare të stokut në Depot Doganore<sup>2</sup>-Prioritet i Lartë

**E gjetura** Mangësitë në mbikqyrjen e depove doganorë gjatë vitit 2013, kanë rezultuar me mungesën e informatave për gjendjen fillestare të stokut në depot doganore në fillim vitin 2014. Edhe pse Dogana ka treguar progres në këtë drejtim, duke formuar sektorin e mbikqyrjes së procedurave me ndikim ekonomik, i cili ka ndermarr veprime konkrete për monitorimin e vazhdueshëm të depove doganore.

**Rreziku** Mungesa e kontrolleve dhe mbikëqyrjes në Depot Doganore ka rezultuar me mos efikasitetin e depove doganore dhe njëkohësisht e rrit rrezikun ndaj humbjeve dhe shmangieve të obligimeve doganore (tatimore) nga ana e këtyre subjekteve.

**Rekomandimi 5** Drejtori i Përgjithshëm duhet të siguroj se ka forcuar mbikëqyrjen e depove doganore duke shtuar kontrollet në këto subjekte, për të verifikuar nëse janë duke u zbatuar kushtet e autorizimeve dhe për të verifikuar gjendjen e stokut.

---

<sup>2</sup> Depo (Magazinë) doganore nënkuptohet çdo vend i aprovuar, i cili është nën mbikëqyrje nga Dogana, ku mallrat mund të strehohen sipas kushteve të parapara. Depo doganore mund të jetë çfarëdo lokacioni i definuar (p.sh. objekt apo vend/hapsirë) i autorizuar nga dogana për deponim të mallrave jo-vendore.

---



## **Çështja 6 – Kthimi i mjeteve si rezultat i proceduarve ankimore – Prioritet i lartë**

- E gjetura** Në bazë të parashtrimit të ankesave të subjekteve ankimore lidhur me kthimin e mjeteve në emër të taksave, varësisht se për çfarë kategori të taksës bëhet fjalë, të cilat janë shqyrtuar nga sektori përkatës dhe pas shqyrtimit të këtyre ankesave janë marrë aktvendime për kthimin e mjeteve në vlerë prej 1,504,381€. Si rezultat i marrjes këtyre aktvendimeve për kthimin e mjeteve, doli që në këto raste nuk ishin përdorur metodat e duhura nga Dogana për përcaktimin e vlerës së importeve apo shkarkimeve në depo doganore në periudhën kur kanë ndodhur ato.
- Rreziku** Kontrollat jo të duhura në vlerësimin e importeve (përcaktimin e vlerave) të mallit dhe shkarkimit të depove ka rezultuar me një numër të konsiderueshëm të rasteve të ankesave nga subjektet ankimore.
- Rekomandimi 6** Drejtori i Përgjithshëm duhet të sigurojë kontrolle adekuate duke ngritur nivelin e performancës në përcaktimin e vlerave të importeve, në mënyrë që të reduktohet aq sa është e mundur numri i ankesave nga subjektet ankimore.

## **4.3 Shpenzimet**

Dogana ka të dizajnuar sistemin e kontrollit të brendshëm, si dhe funksionon në përputhje me atë me përjashtim të disa rasteve/dobësive të cilat ekzistojnë sa i përket procedurave të shpenzimeve në Prokurim dhe tek Pagat dhe Meditjet.

### **4.3.1 Prokurimi**

#### **Përshkrimi**

Shpenzimet totale të Doganës përmes procedurave të prokurimit janë në vlerë prej 3,541,331€. Ne kemi testuar 20 pagesa nga mallrat dhe shërbimet, si dhe pesë pagesa nga investimet kapitale.

Po ashtu, për të vlerësuar pajtueshmërinë e procedurave të prokurimit me Ligjin e Prokurimit Publik ne kemi testuar 12 aktivitete të prokurimit. Në përgjithësi në Doganë kontrollet kanë funksionuar në mënyrë efektive, megjithatë janë disa mangësi të cilat duhet të adresohen për ta përmirësuar procesin në tërësi.

## Rekomandimi

---

### Çështja 7 - Dhënia e kontratës pa sigurimin e sigurisë së ekzekutimit - prioritet i lartë

**E gjetura** Në kontratën “Furnizim me peshore Elektronike me kapacitet min. 60ton” në vlerë 70,800€. Është shpërblyer me kontratë Operatori Ekonomik edhe pse kishte dështuar të përmbush kriterin sigurimi i ekzekutimit të tenderit i së paku 10% të vlerës së kontratës.

**Rreziku** Mos aplikimi i sigurisë së ekzekutimit të tenderit përveç që është në kundërshtim me legjislacionin në fuqi, njëkohësisht kjo mund të ndikojë në heqjen e përgjegjësisë ndaj kontraktuesit nga ana e OE.

**Rekomandimi 7** Drejtori i Përgjithshëm duhet të siguroj ngritjen e nivelit të kontrollit në mbarvajtjen e procesit të prokurimit sipas kërkesave ligjore. Më tutje, duhet të siguroj që me rastin e nënshkrimit të kontratës, paraprakisht është depozituar siguria e ekzekutimit e barabartë apo jo më pak se 10% e vlerës së kontratës.

### Çështja 8 - Pranimi i shërbimeve të kualitetit të dobët - Prioritet i lartë

**E gjetura** Në pagesën prej 27,039€ për “Mirëmbajtjen e automjeteve”, zyrtari pranues dhe komisioni për pranimin e mallit, kanë pranuar shërbimet e ofruara nga OE, për të cilat pastaj Dogana ka refuzuar të ekzekutoj pagesën duke i cilësuar si shërbime të kualitetit të dobët. Të njëjtën e kishte paguar pjesërisht dhe me pas e kishte ndërprerë kontratën me OE. Përveç kësaj, Dogana ishte vonuar në pagesën e një fature, konkretisht i kishte tejkaluar afati kohor për 60 ditë.

**Rreziku** Aktivitetet aktuale të kontrollit dhe monitorimit gjatë pranimin të mallrave, nuk kanë ofruar sigurinë e duhur që paraja publike është shpenzuar për mallrat dhe shërbimet e kontraktuara.

**Rekomandimi 8** Drejtori i Përgjithshëm duhet të siguroj monitorim të mjaftueshëm në pranimin e mallrave dhe shërbimeve, si dhe të merren veprimet e duhura për të siguruar që shpenzimi i parasë publike bëhet në mënyrë efikase dhe duke eliminuar rreziqet/devijimet nga rregullat ligjore.

## Çështja 9 - Klasifikim jo adekuat i kodit ekonomik – Prioritet i lartë

- E gjetura** Në aktivitetin e prokurimit “Shpimi i tokës (Hapja e pusit ) dhe vendosja e gypave me diametër 200mm” në vlerë prej 2,348€ është klasifikuar me kodin ekonomik 13460 (Shërbime kontraktuese tjera). Për kah natyra dhe vlera, këto shpenzime do të duhej të planifikohen/realizohen nga investimet kapitale dhe të regjistroheshin në kodin përkatës të investimeve kapitale.
- Rreziku** Klasifikimi jo i duhur rezulton me nënvlerësim të pasurisë. Realizimi i investimeve kapitale nga mallrat dhe shërbimet redukton transparencën lidhur me investimet kapitale. Njëherit regjistrimi i gabuar i shpenzimeve në kategori dhe kode jo adekuate ndikon në humbjen e besueshmërisë në cilësinë e informatave të raportuara duke mbivlerësuar një kategori dhe nënvlerësuar kategorinë tjetër të shpenzimeve.
- Rekomandimi 9** Drejtori i Përgjithshëm duhet të siguroj vendosjen e një sistemi funksional të kontrollit rreth procedimit të pagesave për mallra dhe shërbime për të siguruar që pagesat janë regjistruar dhe raportuar në kode ekonomike adekuate për të evituar mangësit në këtë fushë.

### 4.3.2 Kompensimet (pagat dhe mëditjet)

#### Përshkrimi

Pagat dhe Mëditjet paguhen përmes një sistemi të centralizuar. Kontrollat që operojnë në Doganën e Kosovës kanë të bëjnë me autorizimin e Payroll-it, një analizim i variancave dhe harmonizimeve të ndryshme. Numri i punëtorëve të aprovuar ishte 622 ndërsa gjatë 2014 numri i punëtorëve në fund të vitit ishte 565. Gjatë vitit 2014 nuk ka pasur rekrutim të stafit në Doganën e Kosovës.

Ne kemi testuar trembëdhjetë mostra ku kemi kryer teste substanciale dhe njëmbëdhjetë mostra në të cilat kemi aplikuar teste të pajtueshmërisë. Nga testimet tona kanë shpalosur të gjeturat si në vijim:

## Rekomandimet

---

### Çështja 10 - Ndalesat për shfrytëzim të pushimit mjekësor, për stafin civil nuk janë në pajtim me ligjet dhe rregulloret në fuqi - Prioritet i lartë

**E gjetura** Ndalesat për shfrytëzim të pushimit mjekësor, për stafin civil nuk janë në pajtim me ligjet dhe rregulloret në fuqi. Në vendimin për ndalesat për pushim mjekësor sipas U.A 91/2010, i gjithë stafi ka të drejtë maksimum 20 ditë pune, pushim të paguar mjekësor pa shtesat e aplikueshme. Në këtë UA ceket qartë që rregullat dhe procedurat për shërbyes civil janë të përcaktuara me dispozitat ligjore për shërbyes civil. Pavarësisht kësaj, ne kemi vërejtur se këto ndalesa janë bërë edhe për stafin civil.

Sipas Rregullores Nr. 06/2011 Për pushimet e nënpunësve civil, nëpunësi civil ka të drejtë në pushim mjekësor me pagesë në kohëzgjatje deri në njëzet (20) ditë pune brenda një (1) viti, me kompensim 100% të pagës.

Gjatë vitit 2014, për të punësuarit me status shërbyes civil, janë aplikuar ndalesa në vlerë 950€. Sipas zyrtarëve të DK-së, arsye për aplikimin e këtyre ndalesave ishte për t'i ndaluar stafin në përgjithësi marrjen e pushimeve të shpeshta mjekësore, përderisa në vitin 2015 nuk ka raste të tilla.

**Rreziku** Aplikimi i ndalesave në pagë për pushime mjekësore për stafin civil rrezikon humbjen e besueshmerisë së kontrolleve në Doganë dhe njëkohësisht mund të ndikojnë në demotivimin e stafit.

**Rekomandimi 10** Drejtori i Përgjithshëm duhet të siguroj se ka respektuar të drejtën e shfrytëzimit të pushimit mjekësor për stafin civil pa aplikuar ndalesat në pagë.

### Çështja 11 - Pagesa për reprezentacion jo nga kategoria e duhur - Prioritet i mesëm

**E gjetura** Pagesa për shpenzime të reprezentacionit është kryer nga kategoria e pagave. Kjo është bërë me anë të një vendimi të ZKA-së, me anë të cilit kërkohet që pagesat për shtatë udhëheqësit e drejtorive rajonale dhe zyrtarit për komunikim dhe media të bëhet nga kategoria e pagave. Pas pranimit të memos së përkohëshme të auditimit, DK ka nxjerr urdhëresën përmes së cilës ka rregulluar pagesën e këtyre shpenzimeve nga kategoria e duhur.

**Rreziku** Vendimi për pagesë të reprezentacionit nga kategoria e pagave nuk ka bazë ligjore, ndërsa pagesa e shpenzimit nga kategoria e pagave dhe mediat nuk është në përputhje me planin kontabël si dhe rrezikon të zvogëlojë shpenzimet për mallëra dhe shërbime dhe të rrisë shpenzimet e pagave.

**Rekomandimi 11** Drejtori i Përgjithshëm, duhet të siguroj që shpenzimet e reprezenatacionit janë paguar nga kategoria adekuate.

## Çështja 12 - Mungon përshkrim i qartë i detyrave dhe përgjegjësi - Prioritet i lartë

### E gjetura

Në të gjitha mostrat e testuara mungon përshkrimi i duhur i detyrave dhe përgjegjësi të punësuarve, përderisa në katër raste kemi vërejtur që zyrtarët nuk kanë fare përshkrim të detyrave dhe përgjegjësi. Në një mostër zyrtarja ka ndërruar gradën ndërsa përshkrimin e detyrave e ka me gradë të vjetër.

Në disa raste zyrtarët kanë ndërruar departamentin ndërsa në dosje kanë të bashkangjitur detyrat dhe përgjegjësitë sipas pranimit në punë. Gjithashtu edhe me rastet e emërimeve në detyrë nuk ka përshkrim të detyrave të reja të punësuarve. Të gjithë këta zyrtarë janë ngritur në gradë, janë transferuar apo janë emëruar përkohësisht. Këtyre zyrtarëve në dosje ju figurojnë përshkrime të vjetra të punës.

Sipas zyrtarëve të DK-së të punësuarit kanë të përshkruar detyrat e punës sipas gradave me anë të përshkrimit të punës sipas strukturës organizative 2012. DK, në vitin 2014 ka strukturë të re organizative dhe ende nuk ka përgatitur përshkrimin e detyrave sipas kësaj skeme organizative. Sipas zyrtarëve të Doganës, do të plotësohen të gjitha dosjet personale të stafit me përshkrimet e detyrave të punës pas finalizimit nga Projekti Binjakëzimit.

Më tutje, Zyrtarja Administrativo-ligjore është transferuar nga Departamenti i Personelit në Njësinë e Auditimit të Brendshëm me të njëjtin titull të pozitës. Megjithatë, në raportet e auditimit të ofruara nga NjAB zyrtarja figuron si anëtare e auditimit.

### Rreziku

Mungesa e përshkrimit të qartë të detyrave dhe përgjegjësi si dhe transferimin e zyrtarëve në pozita për të cilat nuk janë kompetent, rrezikon performancën e organizatës në përgjithësi.

### Rekomandimi 12

Drejtori i Përgjithshëm duhet të siguroj përshkrim të qartë të detyrave dhe përgjegjësi të bëhen sa më shpejtë që është e mundur. Me rastin e transferimit të punonjësve apo emërimeve në detyrë, duhet të bëhet azhurnimi i dosjeve me pozita të aprovuara.

## 4.4 Pasuritë dhe detyrimet

### 4.4.1 Pasuritë kapitale dhe jo-kapitale

#### Përshkrim

Vlera e pasurive jo financiare kapitale (mbi 1,000€) e paraqitur në PVF ishte 4,803,470€, ndërsa vlera e pasurive jo kapitale (nën 1000€) ishte 364,570€ si dhe stoqet në vlerë prej 195,396.98€.

Ne kemi shqyrtuar kontrollet e menaxhmentit dhe proceset shoqëruese që janë zbatuar për menaxhimin e pasurive të DK-së. Testimet tona kanë nxjerr në pah mangësi të mëdha në menaxhimin e pasurive në DK, si në vijim:

---

#### Çështja 13 – Mangësi në Menaxhimin e Pasurive të Doganës – Prioritet i lartë

**E gjetura** Gjatë vitit 2014, kishte lëvizje të zyrtarit të pasurisë, si rezultat, blerjet e pasurisë prej Shtatorit 2014 deri në përfundim të vitit nuk janë përfshi në regjistrin kontabël dhe regjistrin e përgjithshëm të pasurive. Mostrat e testuara në vlerë prej 125,785€ të blerjeve dhe pranimeve të pasurive në këtë periudhë nuk janë përfshir në regjistrin kontabël dhe regjistrin e përgjithshëm të pasurive për vitin 2014. Menaxhmenti i DK-së nuk ka siguruar kontrollet e duhura në menaxhimin e pasurisë që do të siguronin plotësin dhe saktësin e pasurisë së prezantuar në PVF 2014.

Dogana e ka formuar komisionin për inventarizim e pasurisë i cili e ka kryer inventarizimin dhe ka përgatitur raportin e inventarizimit. Mirëpo nuk ka formuar komision për vlerësimin e pasurisë jo financiare. Edhe pse sipas zyrtarëve të Doganës në vitin 2015 është formuar ky komision dhe është duke e vlerësuar pasurinë.

Gjithashtu, DK-së nuk ka funksionalizuar regjistrin E-pasuria. Sipas rregullores për menaxhimin e pasurive, çdo organizatë buxhetore duhet mbajë regjistrin E-pasuria, për evidentimin e pasurive me vlerë nën 1,000€. Pastaj, ky regjistër duhet të jetë i harmonizuar me regjistrin e përgjithshëm të pasurive.

**Rreziku** Kontrollet e dobëta në menaxhimin e pasurisë kanë rezultuar me mangësi të shumta në këtë komponent të cilat e rrisin rrezikun ndaj humbjeve apo keqpërdorimit të tyre.

**Rekomandimi 13** Drejtori i Përgjithshëm duhet të analizojë arsyet për mangësit e paraqitura në menaxhimin e pasurisë për vitin 2014. Po ashtu të siguroj prezantimin e saktë dhe të plotë të pasurive në PVF 2015.

## 4.4.2 Trajtimi i të arkëtueshmeve

### Përshkrim

Bazuar në informatat e prezantuara në pasqyrat vjetore financiare, Dogana ka të hyra të pa arkëtuara në vlerë prej 34,617,788€. Shumica e këtyre të arkëtueshmeve i takojnë lojrave të fatit. Cështjen e ndërlidhur me saktësinë dhe plotësinë e arkëtueshmeve në PVF 2014 e kemi prezantuar tek nënkapitulli 2.2.

---

### Çështja 14- Të hyrat e pa arkëtuara - Prioritet i lartë

- E gjetura** Trajtimi i borxheve mbetet sfidë për Doganën. Mungesa e një analize për të identifikuar/nxjerrur shkaktarët e dështimit të bizneseve në pagesën e borxheve të caktuara nga Dogana ka rezultuar me një inkasim të dobët të tyre.
- Rreziku** Borxhet e pa arkëtuara zvogëlojnë aftësinë e Doganës në arkëtimin e tyre si dhe krijon rast precedent për debitorët e tjerë të cilët mund të vendosin të mos paguajnë.
- Rekomandimi 14** Drejtori i Përgjithshëm duhet të identifikoj çdo borxhëlinj ndaj Doganës, dhe të shqyrtojë vjetërsinë dhe vlefshmërinë e borxheve individuale dhe të zbatojë një proces sistematik të trajtimit të atyre borxheve që konsiderohen të pa mbledhshme - (duhet të klasifikohen, dokumentohen dhe validohen). Të gjitha mjetet në dispozicion të shfrytëzohen, përfshirë veprimet ligjore. Rishikimi duhet të përfshihë një analizë në mënyrë që të nxjerr shkaktarët e dështimit të bizneseve në pagesën e borxheve ndaj Doganës.

## 4.5 Sistemi i auditimit të brendshëm

### Përshkrimi

Njab në DK përbëhet nga Drejtori, dhe një auditor. Kjo njësi kryen aktivitetet e saj audituese sipas planit strategjik dhe atij vjetor dhe i raporton Komitetit të auditimit.

Komiteti i auditimit është i themeluar në kuadër të MF-së. DK raporton në këtë komitet me anë të një përfaqësuesi. Komiteti i auditimit për periudhën janar-dhjetor 2014 ka mbajtur katër takime, ku janë diskutuar të gjeturat dhe implementimi i rekomandimeve të DK.

Njab raporton edhe në Njësinë Qendrore Harmonizuese për auditim të brendshëm me anë të raporteve tremujore.

Në planin vjetor janë paraparë tetë (8) auditime të rregullta, përderisa nuk janë paraparë auditime me kërkesë. Njab gjatë vitit 2014 ka kryer shtatë (7) auditime sipas planit vjetor të auditimit dhe dy (2) auditime me kërkesë.

Dogana e Kosovës ka një Njësinë e auditimit të brendshëm si segment i rëndësishëm i kontrolleve në përgjithësi. Njab ka operuar në bazë të planit.

---



## Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZAP

(e shkëputur nga ISSAI 200)

### Forma e opinionit

147. Auditori duhet të japë një **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Nëse auditori, bazuar mbi dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë anomali materiale ose nuk arrin të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë anomali materiale, atëherë ai duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit sipas pjesës që flet për ‘Përcaktimin e llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit’.

148. Nëse pasqyrat financiare të përgatitura sipas kërkesave të një kornize për prezantim të drejtë nuk arrijnë të japin një paraqitje të drejtë, auditori duhet të diskutojë çështjen me menaxhmentin dhe, varësisht nga kërkesat e kornizës së zbatueshme për raportim financiar dhe nga mënyra se si zgjidhet çështja, të përcaktojë nëse është e nevojshme të modifikojë opinionin e auditimit.

### Modifikimet që i bëhen opinionit në raportin e auditorit

151. Auditori duhet të modifikojë opinion në raportin e auditorit në rast se, duke u bazuar në dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë gabime materiale, ose në qoftë se auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë anomali materiale. Auditorët mund të japin tre lloje opinionesh të modifikuara: opinion të kualifikuar, opinion të kundërt dhe mohim të opinionit.



Përcaktimi i llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit

152. Vendimi se cili lloj i opinionit të modifikuar është i përshtatshëm varet nga:

- Natyra e çështjes që i jep shkas modifikimit – d.m.th nëse pasqyrat financiare përmbajnë anomali materiale ose, në rast se ishte e pamundur për të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, mund të përmbajnë anomali materiale; dhe
- Gjykimi i auditorit rreth përhapjes së efekteve ose efekteve të mundshme që çështja ka në pasqyrat financiare.

153. Auditori duhet të japë një **opinion të kualifikuar** nëse: (1) pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se anomalitë, ose individualisht ose së bashku, janë materiale por nuk janë përhapur në pasqyrat financiare, ose (2) nëse auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, por arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë materiale por jo të përhapura.

154. Auditori duhet të japë një **opinion të kundërt** nëse, pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se anomalitë, ose individualisht ose së bashku, janë edhe materiale edhe të përhapura në pasqyrat financiare.

155. Auditori duhet japë **mohim të opinionit** nëse, pasi nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, auditori arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë edhe materiale edhe të përhapura. Nëse, pas pranimit të angazhimit, auditori bëhet i vetëdijshëm se menaxhmenti ka imponuar një kufizim të fushëveprimit të auditimit, për të cilin auditori konsideron se mund të rezultojë në nevojën për të shprehur një opinion të kualifikuar ose mohim opinionit mbi pasqyrat financiare, auditori duhet të kërkojë nga menaxhmenti ta heqë atë kufizimin.

Nëse auditori jep një opinion të modifikuar, ai duhet të modifikojë edhe titullin për të korresponduar me llojin e opinionit i shprehur. ISSAI 1705 jep udhëzime shtesë rreth gjuhës specifike që duhet përdorur kur jepet një opinion dhe për të përshkruar përgjegjësinë e auditorit. Ajo gjithashtu përfshin shembuj ilustrues të raporteve.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

157. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për të tërhequr vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka prova të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban anomali materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë një paragrafi të Theksimit të Çështjes në raportin e tij. Paragrafët për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohen vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

158. Një paragraf i Theksimit të Çështjes duhet:

- Të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- Të ketë titullin 'Theksim i Çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- Të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç' pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen;
- Të tregojë se opinionimi i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

159. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për ta komunikuar një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që ta kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje Të Tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të Çështjes.



	<p><b>Çështja - Agjencionet e Përfaqësimit operojnë të palicencuara-Prioritet i lartë</b></p> <p>Drejtori Përgjithshëm duhet të siguroj që të gjitha Agjencionet e Përfaqësimit pajisen me licencë ose në të kundërtën t'u ndalohet aktiviteti i përfaqësimit.</p>			
4.4.3 Kompensimet (pagat dhe mëditjet)	<p><b>Çështja - Mangësi sa i përket koeficienteve (gradimeve ) të nëpunësve civil dhe ushtrimit të detyrës më gjatë se tre muaj- Prioritet i mesëm</b></p> <p>Drejtori i Përgjithshëm duhet të siguroj që koeficientet e pagës për nëpunësit civil janë në përputhshmëri me detyrat dhe përgjegjësitë e tyre dhe që pozitat drejtuese nuk mbahen me ushtrues detyre më gjatë se tre muaj.</p>	X		
4.5.1 Pasuritë kapitale dhe jo-kapitale	<p><b>Çështja - Lëvizjet (Transferet) e Pasurisë pa informimin e Zyrtarit të Pasurisë- Prioritet i mesëm</b></p> <p>Drejtori i Përgjithshëm duhet të siguroj që çdo lëvizje e pasurisë të bëhet me formën standarde të ngarkim-shkarkimit dhe të dërgohet te zyrtari i pasurisë për qëllime të rifreskimit të listës së pasurisë .</p>	X		